

01-987



Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 14 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05Nr.391/02-130692/22 dt.08.06.2022, të kërkuësve/bashkëpronarëve, Skender Krasniqi nga Prishtina dhe investitorit “Lin-Projekt” sh.p.k., me seli në Mitrovicë, në rr. “Mbretresha Teutë” pn., për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërtesën shumëbanesore me afarizëm, përkatësisht ndërtesa “2”, të ndërtuara në kuadër të bllokut urban “A7”, të Planit Rregullues “Mati 1”, në rr. “Ndue Perllëshi”, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës në procedurë administrative, me datë 11.06.2024, lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LEJOHET kërkuësve / bashkëpronarëve, Skender Krasniqi nga Prishtina dhe investitorit “Lin-Projekt” sh.p.k., me seli në Prishtinë, në rr. “Mbretresha Teutë” pn., sipas kërkesës 05Nr.391/02-130692/22 dt.08.06.2022, përdorimi i ndërtesës shumëbanesore me afarizëm, përkatësisht ndërtesa “2”, me etazhitet B+P+11, e ndërtuar sipas “Vendimit për Lejimin e Ndërtimit”, 05Nr.351/02-293356 dt.27.06.2016, dhe “Konkluzionit”, 05Nr.351/02-293356 dt.20.03.2017, në parcelave kadastrale nr. 1520-0, dhe 664-34, ZK Matiçan, konkretisht në kuadër të bllokut urban “A7”, të Planit Rregullues “Mati 1”, në Prishtinë.

II. Ndërtesat nga pika I. e këtij vendimi, ndodhen në rrugën “Ndue Perllëshi” ku kanë dalje hyrjet e këtyre ndërtesave me numrat: 159, 161, 163, 165, 167, dhe 169, në Prishtinë, dhe të njejtat do të përdoren dhe shfrytëzohet sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

III. Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesave dhe njësive të tyre në evidencat e regjistrit kadastral.

VI. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

A r s y e t i m

Kërkuësit / bashkëpronarët, Skender Krasniqi nga Prishtina dhe investitorit “Lin-Projekt” sh.p.k., me seli në Prishtinë, në rr. “Mbretresha Teutë” pn., me kërkesën me 05Nr.391/02-130692/22 dt.08.06.2022, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për kompleksin me ndërtesa shumëbanesore me afarizëm, përkatësisht ndërtesa, “2”, me etazhitet B+P+11, e ndërtuar në kuadër të bllokut urban “A7”, të Planit Rregullues “Mati 1”, në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelave kadastrale nr. 1520-0, dhe 664-34, ZK Matiçan, ndërtuar sipas “Vendimit për Lejimin e Ndërtimit”, 05Nr.351/02-293356 dt.27.06.2016, dhe “Konkluzionit”, 05Nr.351/02-293356 dt.20.03.2017,

të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit, e Komunës së Prishtinës si dhe pranuar teknikisht nga komisioni përkatës.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Sektorit i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare "Akt përcjellës", me referencë 09 Nr. 391/02-100741/21 dt. 26.05.2022, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizmit, Raportet e Inspektimit Final të punëve dhe përshkrimit të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkesit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Fotografji gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testimeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikqyrësi Bedri Asllani; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikqyrësi Jeton Canhasi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjetillësit dhe kanalizimit, nga mbikqyrësi Agron Beshiri; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektike, nga mbikqyrësi Lulzim Bunjaku; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikqyrësi Enver Haxhimehmeti; Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga kompania gjeodeze e licensuar "Geo-Group" sh.p.k me nr. të licensës 52;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjetillësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht për kompleksin me ndërtesa shumëbanesore me afarizëm, mund të përdoret.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezentuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesa shumëbanesore me afarizëm, mund të përdoret, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesën shumëbanesore me afarizëm.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Vendim, përmes kësaj Drejtorie, me ankesë mund t'i drejtohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, brenda afatit prej 30 ditësh duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij Vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-ja.

I dorëzohet: Kërkesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,

05 NR. 391/02-130692/22 DT. 11.06.2024

Zyrtarja,

Bahtije Vllasaliu



Udhëheqëse e Sektorit

Nazife Krashniqi

Faqe 2 prej 3